

## ACPD

### *1 ne 4 vajza adoleshente amerikane mbartin Infeksione Seksualisht të Transmetueshme (IST)*

Një studim i realizuar nga Qendra e Parandalimit dhe e Kontrollit të Sëmundjeve në SHBA ka treguar se 26 % e vajzave të reja të moshës 14- 19 vjeç janë të infektuara me infeksione seksualisht të transmetueshme.

Ky studim u prezantua në 11/mars/2008 në Chicago, në Konferencën Kombëtare për Parandalimin e IST-ve. Është studimi parë i cili vëzhgoi prevalencën e IST-ve tek vajzat adoleshente amerikane.

Kjo përqindje ekuivalentohet me shifrën 3.2 milion vajza adoleshente në SHBA të cilat mbartin një IST (Klamidia, Herpes, Human Papilomavirus,etj).

Drejtuesja e këtij studimi Sara Forhan, theksoi faktin se adoleshentët afro-amerikane kishin një përqindje më të larta se vajzat e bardha. Kështu sipas studimit nga testimi i vajzave afro-amrikane 48% e tyre ishin të infektuara ne krahasim me 20% me vajzat e bardha. Forhan gjithashtu theksoi se testimi është realizuar vetëm për disa prej IST, dyshohet se nëse ky testim do të kryhej për të gjitha IST prevalenca do të ishte shumë më e lartë.

Disa infeksione mund të jenë të shërueshme, por të tjerat mund të shkaktojnë deri infertilitet apo kancer të mitrës, kjo tregon se vaksinimi apo strategjitë parandaluese duhet të kenë një priritet të lartë për të kuruar efektet shkatërruese të IST-ve.

Rritja e informimit dhe e ndërgjegjësimit për Infeksione Seksualisht të Transmetueshme tek adoleshentet është thelbësore.